



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së parë të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 13.02.2026, në sallën e Bordit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Gentianë Hoxhaj , anëtare
2. Hyra Bytyqi, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Yllëza Bedrolli, anëtare
5. Alush Bikliqi, anëtar
6. Slavisa Trajkovic, anëtar
7. Maksut Gashi, anëtar,
8. Zoran Cirkovic, anëtar
9. Ollga Guciq, anëtare
- 10.Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

- 1.Daut Azemi, kryesues i Kuvendit
- 2.Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
- 3.Fisnik Dida, përfaqësues i OSBE-së

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu,**

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se me komitetin për komunitete mandatin e kaluar kemi pas bashkëpunim të mirë presim të vazhdojmë me bashkëpunime edhe këtë mandat. Takimin e parë do ta udhëheq unë derisa të zgjidhet Kryesuesi i Komitetit për Komunitete.

Pastaj tha, se çka do që keni nevojë si komitet do ta keni mbështetjen time si kryesues por edhe të Sektorit të Kuvendit. Po ashtu tha se për çdo pikë që do ta keni si komitet në rend të ditës do të jenë edhe drejtoret e drejtorive ose ndonjë zyrtar prezent lidhur me pikat e caktuara.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se ftesën me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim:

R E N D D I T E

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete
2. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimitisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi,, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush ndonjë propozim për Kryesues të Komitetit për Komunitete

Sllavisha Trajkovic, tha se për ata që nuk me njohin unë kam qenë 3 mandate në këtë komitet dhe përfaqësojmë komunitetin serbe si komitet kemi kaluar shumë mirë mandatin e kaluar duke u munduar të bëjmë më të mirën për komunitetin tonë, Pastaj tha se për Kryesues të Komitetit propozoj Alush Bikliqin i cili ka një përvojë të mirë dhe besoj që do ta kryej mirë punën.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi e vuri në votim propozimin që Kryesues i Komitetit për Komunitete të zgjidhet Alush Bikliqi, dhe pas votimit, u konstatua se Komiteti unanimitisht me 10 vota për e zgjodhi Alush Bikliqin për Kryesues të Komitetit për Komunitete.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, ia kaloi fjalën kryesuesit të posa zgjedhur.

Alush Bikliqi, tha se ju falënderoj të gjithëve për besimin dhe mbështetjen, për mua do të jetë privilegj por edhe një detyrë shtesë, por unë se bashku me juve do të mundohemi që të bëjmë më të mirën për komunitetin të cilin e përfaqësojmë. Pres mbështetjen tuaj edhe këtë mandat për të mirën e qytetarëve të Komunës tonë.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i sapo zgjedhur i komitetit , Alush Bikliqi, tha se është mirë në bashkëpunim me OSBE-në me organizuar një punëtori dhe aty të diskutoni rreth planit të punës së komitetit.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15¹⁵.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Alush Bikliqi